



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 94 par. 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 04/L-082), nenit 18 të Ligjit nr. 05/L-129, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe neneve 4 dhe 7 të Rregullorës nr. 01/39, mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në mbledhjen e 214-të, të mbajtur me datë 21 shkurt 2019, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KGJK-së nr. 151/2017 i datës 31.5.2017 me të cilin caktohet përbërja e anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të Panelit për lirim me kusht;
- II. Pika 2, nën pika 2.3 e vendimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij vendimi ndryshohet dhe plotësohet, me tekstin si në vijim:
  1. Arben Hoti, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë emërohet anëtar i Panelit për lirim me kusht;
- III. Mandati i anëtarit të Panelit për lirim me kusht është dy (2) vite;
- IV. I emëruari do të ushtrojë funksionin e anëtarit të panelit, për të përbërë panelin dhe për të vendosur në kërkesat dhe propozimet për lirim me kusht;
- V. Anetari i Panelit kompensohet në bazë të Udhëzimit Administrativ për Kompensimin e Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosoves, anëtarëve dhe Zyrtarëve tjerë në Komisione
- VI. Vendimi hynë në fuqi me datë 21 shkurt 2019.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK. nr. 152/2017 të datës 31.5.2017 në pajtim me nenin 18 të Ligjit nr. 05/L-129, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale e ka ndryshuar përbërjen e anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të Panelit për lirim me kusht.

Sipas nenit 18 të Ligjit nr. 05/L-129, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve, një (1)

gjiqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) gjyqtar i Gjykatës së Apelit i deleguar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe **një (1) gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Themelore.**

Me vendimin KGJK. nr. 253/2018 të datës 27.12.2018 znj. Drita Rexhaj, gjyqtare e Gjykatës Themelore në Prishtinë është avancuar në pozitën e gjyqtares së Gjykatës së Apelit të Kosovës, andaj sipas dispozitave të ligjit në fuqi e njëjta nuk mund të ushtrojë mandatin e anëtarit të Panelit për lirim me kusht.

Prandaj, me vendimin e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë GJA. nr. 39/2019 të datës 24.1.2019, në përbërje të Panelit për lirim me kusht është deleguar Arben Hoti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 18 të Ligjit nr. 05/L-129, për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-149, për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

Nehat IDRIZI,  
  
Kryesues i Keshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Z. Arben Hoti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
- Anëtareve të Panelit për lirim me kusht;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Koordinatorit të Panelit për Lirim me Kusht;
- Arkivit të KGJK-së.